



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Nga: Komuna e Prishtinës

Për: UNISDR "Making Cities Resilient" Campaign

Nga UNDP (United Nations Development Programme) jemi njoftuar për kampanjën "T'i bëjmë qytetet e qëndrueshme" 2010-2011. Edhe pse Komuna e Prishtinës nuk i përket grupit "qytet i qëndrueshëm roli-model", ne dëshirojmë që te marrim pjesë në këtë kampanjë si "Qytet I qëndrueshëm pjesmarrës". Ne premtojmë angazhimin tonë në ngritjen e këtyre pikave nga lista kontrolluese:

1. Mirëmbajtja e përhershme e të dhënave për rreziqet dhe vulnerabilitetin (prekshmërinë), **pergatitja e vlerësimeve të riskut dhe përdorimi i tyre si bazë për zhvillimin e planeve dhe vendimeve urbanistike.**
2. Sigurimi që programet e edukimit dhe trajnimit për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë janë duke u aplikuar në shkolla dhe komunitetet lokale.
3. Vlerësimi i sigurisë i të gjitha shkollave dhe objekteve shëndetësore dhe ngritja e atyre nëse është e nevojshme.

Si kryetari I Komunës së Prishtinës, ju siguroj që institucionet e mëposhtme në bashkëpunim me Drejtorine tonë për Mbrojtje dhe Shpëtim do të bashkëpunojnë në ngritjen e pikave të cilat u përmenden më lartë:

1. Kryqi i Kuq i Kosovës
2. Minitria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
3. Departamenti për Menaxhimin e Emergjencave - Ministra e Punëve të Brendshme
4. United Nations Development Programme

Datë.14.05.2010

Prishtinë

